



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranverorë

Kryesia e Kuvendit, në bazë të nenit 67.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2015, pasi shqyrtoi Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2014, mori këtë


V E N D I M

Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2014, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

Nr. 05-V-32/k
Prishtinë, më 9 mars 2015

Kryetari i Kuvendit,

Kadri VESELI




Vendimi i dërgohet:

- Administratës së Kuvendit,
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



Legjislatura e V-të
Sesioni pranveror

Për: Kryesinë e Kuvendit

Nga: Komisioni për Buxhet dhe Financa

Lënda: Rekomandim për Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014

Nr. 1, Datë: 18.2.2015

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 15.12 dhe 69.5 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 18.2.2015, shqyrtoi Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014, dhe Kryesisë së Kuvendit ia parqet këto

R e k o m a n d i m e

- I. Të miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014.
- II. Kryesia e Kuvendit, të rishikojë Vendimin e Kuvendit të Kosovës nr.02/229-1/06 të datës 17 korrik 2006, për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e "Qendrës Administrative Protokollare" në Gërmi, dhe Kuvendit t'ia paraqet propozimin.
- III. Agjencitë e pavarura të vendosura në ndërtesën e Kuvendit, t'i lirojnë zyret, me qëllim të krijimit të hapësirave për punë për deputetë.


Arsyetim

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 18.2.2015, shqyrtoi Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014, dhe vlerësoi se raporti ofron një pasqyrë të përgjithshme për nivelin e shpenzimeve sipas programeve të buxhetit të Kuvendit, me të dhëna detale të shpenzimeve sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe jepen sqarimet e nevojshme për rrjedhën e shpenzimeve buxhetore për periudhën kohore të raportimit. Si rrjedhojë, Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014, i përmbush kushtet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, dhe i rekomandon Kryesisë së Kuvendit për miratim.

Komisioni vlerëson të domosdoshme që Kryesia e Kuvendit, të rishikojë Vendimin e Kuvendit të Kosovës nr.02/229-1/06 të datës 17 korrik 2006, për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi, dhe Kuvendit t'ia paraqet propozimin konkret lidhur me projektin në fjalë. Gjithashtu, Kryesia e Kuvendit, të kërkojë nga Agjencitë e Pavarura, të vendosura në ndërtesën e Kuvendit, të lirojnë zyret, në mënyrë që të krijohen hapësira apo zyre dhe kushte për punë për deputetët.

Bashkangjitur: Raporti i Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014.

Kryetari i Komisionit,
Naser Osmani



Raporti vjetor Financiar për vitin 2014

Kodi i Organizatës Buxhetore: 101

Informatat kontaktuese: 038 200 10 557

Sekretari i Kuvendit: Ismet Krasniqi, Ndërtesa e Kuvendit, zyra N-122

Drejtori i Përgjithshëm për Administratë: Emrush Haxhiu, Ndërtesa e Kuvendit, zyra N-224

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Pagesa: Istret Azemi, Ndërtesa e Kuvendit, zyra N-221

Datë: 31 dhjetor 2014

1)Hyrje: (Ju lutem paraqitni në formë tekstuale një përmbledhje të zhvillimeve kryesore në buxhetin e organizatës tuaj. Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë!)

Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i ndarë sipas Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014. 04/L-233 është 9.388.157€, ndërsa ai përfundimtar është 8,014,195€, dhe atë sipas kategorive ekonomike në vijim: Paga dhe mëditje 5,534,723 €

mallra dhe shërbime 1,318,201€, shpenzime komunale 187,500€, subvencione dhe transfere 30,000 € dhe shpenzime kapitale 943,421 €. Në buxhetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës pjesën më të madhe të buxhetit e kanë pagat dhe mëditjet me 69.06% mallrat dhe shërbimet me 16.45%, shpenzimet kapitale me 11.77%, shpenzimet komunale me 2.34 dhe subvencionet dhe transferet me 0.37% .

Pra buxheti i ndar për vitin 2014 duket kështu : Paga dhe mëditje 5,534,723€ ,mallra dhe Shërbime 1,318,201 €, Shpenzime komunale 187,500€, Subvencione 30.000 € dhe Investime kapitale 943,421 €,

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm, del se niveli i realizimit të buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2014 është 80.73% e buxhetit përfundimtar.

Alokimi i fondeve është bërë në bazë të planit të rrjedhës së parash të përgatitur nga Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa në bashkëpunim me Menaxhmentin e Kuvendit. Në këtë raport do të paraqiten në mënyrë të hollësishme shpenzimet e realizuara nga buxheti i Kuvendit për vitin 2014 si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtë të vitit 2013

b) Pagat dhe mëditjet:

(Ju lutem, të bashkëngjitet organogrami i organizatës suaj si aneks i këtij raporti financiar dhe plotësoni tabelën shtesë lidhur me strukturën e pagesës në pikën 4 f) të këtij raporti).

Kategoria e Pagave dhe mëditjeve merr pjesë në buxhetin e Kuvendit me 5,534,723 ose 69.06% e buxhetit e alokuar të Kuvendit dhe si të tilla janë të ndara në tri Programe Anëtarët e kuvendit 3,429,618 € Administrata e Kuvendit 1.761.796 € dhe Staf mbështetës Politik 343,309€, shuma e shpenzuar në këtë kategori për këtë vit është **4.932.396,97 ose shprehur** në përqindje 89.12% e buxhetit të ndarë vjetor në këtë kategori. Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve të Deputetëve në këtë vit për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve Parlamentare na është ndarë një shumë prej 1,000,000 € për pagesën e deputetëve që nuk rizgjidhen e paraparë me Ligjin e Deputetëve dhe me Rregulloren e Kuvendit, e të cilat për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare dhe vonesës në konstituimin e Kuvendit shumica e tyre i janë kthyer Qeverisë si kursime.

c) Mallra dhe shërbime:

Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve merr pjesë në buxhetin vjetor me 1,318,201€ ose me 16.45% në buxhetin e Kuvendit dhe si të tilla janë të ndara në tri Programe Anëtarët e Kuvendit 429,250€ , Administrata e Kuvendit 849,150 € dhe Staf mbështetës Politik 39,801€. Shkalla e shpenzimit të buxhetit në këtë kategori ekonomike për vitin 2014 është 966.859,57€, shprehur në përqindje 73.35% e buxhetit në këtë kategori krahasuar me buxhetin vjetor të Kuvendit në Mallra dhe shërbime .

d) Shpenzime komunale:

Kategoria e shpenzimeve komunale merr pjesë në buxhetin e Kuvendit me 187,500 ose 2.34% e buxhetit e Kuvendit këto fonde janë të ndara në programin Administrata e Kuvendit. Shkalla e shpenzimit të buxhetit në këtë kategori ekonomike për vitin 2014 është 143.626,16 €shprehur në përqindje 76,46% e buxhetit në këtë kategori .

e) Investimet Kapitale:

Kategoria e Investimeve Kapitale merr pjesë në buxhetin e Kuvendit me 943,421€, ose me 11.77% ,këto fonde janë të ndara në programin Administrata e Kuvendit. Shkalla e shpenzimit të buxhetit në këtë kategori ekonomike për vitin 2014 është 420.335,65 €, ose shprehur në përqindje 44.55% e buxhetit vjetor ne kete kategori .

f) Subvencionet dhe Transferet:

Kategoria e Subvencioneve dhe transfereve merr pjesë në buxhetin dhjetmujor me 30,000 € ose me 0.37% në buxhetin e Kuvendit , këto fonde janë të ndara në programin Anëtarët e Kuvendit. Shkalla e shpenzimit të buxhetit në këtë kategori ekonomike për vitin 2014 është 6.800 €, ose shprehur në përqindje 22.67 % e buxhetit vjetor ne kete kategori.

3) Përmbledhje:

Ju lutem, paraqitni shkurtimisht vërejtjet përfundimtare lidhur me buxhetin e institucionit tuaj, apo pikëpamjet për zhvillimet në të ardhmen.

Pavarësia financiare është një nga elementet shumë të rëndësishme dhe thelbësore pasi që Parlamenti duhet të ketë kontroll të plotë të mjeteve të tij financiare për të planifikuar dhe kryer aktivitetet e tij. Pavarësia administrative përfshirë vendimet e Parlamentit për çështjet e tij të brendshme nuk mund të ekzistojë pa pavarësinë financiare. Prandaj, kontrolli i duhur parlamentar mbi Qeverinë nuk mund të ekzistojë pa pavarësi financiare dhe buxhetore të vetë Parlamentit. Në vitin 2012 një Komunikatë e Komisionit për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit në mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës ndër të tjera arriti në përfundim se Kuvendi dhe komisionet e tij duhet të zhvillojnë mbikëqyrjen e tyre ndaj ekzekutivit dhe se pavarësia financiare dhe administrative e Kuvendit nga qeveria duhet të fuqizohet. Rekomandimet e Projektit të Binjakëzimit sa i përket Komponentes 5 rëndësinë më të madhe i ka kushtuar hartimit të një Ligji për Kuvendin ku do të definohet qartazi pavarësia financiare e Kuvendit, si në planifikim e po ashtu edhe në ekzekutim të buxhetit. Në këtë vit kemi fituar një donacion nga Bashkimi Evropian për një kontratë Binjakëzimi të lehtë për hartimin e Ligjit për Kuvendin, e nga ekspertët në fjalë kemi pranuar draft Ligjin për Kuvendin, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe disa Rregullore të tjera me të cilat do të rregullohet edhe çështja e Pavarësisë buxhetore dhe Financiare të Kuvendit por edhe çështje të tjera të rëndësishme siç janë edhe TI-së dhe personelit etj..

* 15 % e buxhetit vjetor te ndar sipas ligjit nr 04-L-233 jane shkurtuar sipas vendimit te Qeverise nr. 07/172 te dates 27.02.2014

Nënshkrimi i Sekretarit të Kuvendit

Ismet Krasniqi



4) Tabelat:

a) Të hyrat:

Ju lutem plotësoni tabelën me informatat e nevojshme.

Kodi Ekonomik	Kategoria Ekonomike	Të hyrat e Planifikuara/Parashikuara për këtë periudhë	Të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak	realizuara gjatë kësaj periudhe raportuese
Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk realizon të hyra				

b) Shpenzimet:

Kodi Ekonomik	Buxheti dhe Shpenzimet 2013				Buxheti dhe shpenzimet për vitin 2014			
	Kategoria Ekonomike	Buxheti vjetor përfundimtar 2013	Shpenzimet 2013	% e shpenzimit	Buxheti vjetor me Ligjin e Buxhetit (2014)	Buxheti përfundimtar në SIMFK	Shpenzime vjetore	% e shpenzimit krahasuar me buxhetin përfundimtar në SIMFK
1	2	3	4	5=4/3	6	7	8	10=8/7
11000	Paga dhe Mëditje	5,334,367.00	5,096,023.46	95.53	6,556,332.00	5,534,723.00	4,932,396.97	89.12
13000	Mallra dhe shërbime	1,631,854.00	1,562,754.87	95.77	1,550,825.00	1,318,201.25	966,859.57	73.35
13200	Shërbimet komunale	198,500.00	183,972.48	92.68	221,000.00	187,850.00	143,626.16	76.46
21000	Subvencionet dhe Transferet	60,000.00	59,900.00	99.83	30,000.00	30,000.00	6,800.00	22.67
30000	Investimet Kapitale	896,072.00	637,691.82	71.17	1,030,000.00	943,421.00	420,335.65	44.55
	Gjithsej	8,120,793.00	7,540,342.63	92.85	9,388,157.00	8,014,195.25	6,470,018.35	80.73

Për shkak të vonesës së konstituimit të Kuvendit, në programin e deputetëve dhe të stafit mbështetës politik në kategorinë e pagave dhe mëditjeve kemi një kursim prej 1,021,609€, mjete këto që ia kemi kthyer Qeverisë gjatë procesit të evidentimit të kursimeve në këtë kategori ekonomike. Ndërsa duhet cekur se me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, buxheti për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale është shkurtuar për 15% dhe në këtë raport është marrë si buxhet përfundimtar.

Mallra dhe shërbime

4. c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	MALLRA DHE SHËRBIME Emri i kategorisë ekonomike	Planifikuar 2013	Shpenzimet vjetore 2013	% e shpenzimit	Planifikuar 2014	Shpenzimet vjetore 2014	% e shpenzimit
13100	Shpenzimet e udhëtimit	371,029.00	340,052.37	91.65%			71.63%
13130	Shpenzime te udhetimit brenda vendit	15,500.00	12,102.70	78.08%	210,000.00	150,420.34	96.17%
13140	Shpenzime te udhetimit jashte vendit	355,529.00	327,949.67	92.24%	10,000.00	9,617.40	70.40%
					200,000.00	140,802.94	
13200	SHPENZIME KOMUNALE	198,500.00	183,972.48	92.68%			76.60%
	Ryma	115,000.00	114,895.74	99.91%	187,500.00	143,626.16	93.13%
	Uji	15,000.00	13,442.95	89.62%	100,000.00	93,131.96	98.90%
	Mbeturinat	6,000.00	3,639.55	60.66%	10,000.00	9,890.39	8.31%
	Ngrohja qendrore	-	-		30,000.00	2,492.95	
	Shpenzimet telefonike	62,500.00	51,994.24	83.19%	47,500.00	38,110.86	80.23%
13300	SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT	110,400.00	109,694.77	99.36%			82.16%
13310	Shpenzimet për internet	2,300.00	2,250.00	97.83%	74,600.00	61,290.73	100.00%
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	107,100.00	106,898.36	99.81%	3,600.00	3,600.00	82.25%
13330	Shpenzimet postare	1,000.00	546.41	54.64%	70,000.00	57,574.83	11.59%
13340	Shpenzimet e përdorimit të kabllit optik				1,000.00	115.90	
13400	SHPENZIMET PËR SHËRBIME	95,925.00	85,016.46	88.63%	80,000.00	57,252.37	71.57%
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	11,200.00	11,152.40	99.58%	10,000.00	8,588.00	85.88%
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës			0.00%			
13430	Shërbimet e ndryshme shëndetësore			0.00%			
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	10,200.00	7,970.00	78.14%	10,000.00	1,920.00	19.20%
13450	Shërbime shtypje jo marketing	15,000.00	13,645.00	90.97%	15,000.00	12,226.00	81.51%
13460	Shërbime kontraktuese tjera	53,525.00	46,548.23	86.97%	35,000.00	26,989.37	77.11%
13470	Shërbime teknike	6,000.00	5,700.83	95.01%	10,000.00	7,529.00	75.29%
13780	Shpenzimet për anëtarësim		-			-	
1350	BLERJE E MOBILJEVE DHE PAISJEVE (ME PAK SE 1000 EURO) (NENTOTALI)	101,400.00	100,161.40	98.78%	157,350.25	47,296.79	30.06%
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	13,300.00	13,291.00	99.93%	5,000.00	-	0.00%
13502	Telefona (me pak se 1000 euro)	1,710.00	1,707.23	99.84%			
13503	Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	53,100.00	52,912.78	99.65%	127,350.25	26,980.00	21.19%
13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)						
13505	Makina fotokopjuese (me pak se 1000 euro)						
13506	Pajisje speciale mjeksore (me pak se 1000 euro)						

13507	Pajisje te shërbimit policor (me pak se 1000 euro)						
13508	Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro)						
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	35,000.00	32,250.39	92.14%	25,000.00	20,316.79	81.27%

1360	BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHERBIME (NENTOTALI)	192,000.00	186,732.44	97.26%	120,000.00	114,924.52	
13610	Furnizime për zyrë	192,000.00	186,732.44	97.26%	120,000.00	114,924.52	95.77%
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)						
13630	Furnizime mjekësore						
13640	Furnizime pastrimi						
13650	Furnizim me veshmbathje						
13660	Akomodimi						
13670	Municion dhe armë zjarri						
13680	Tiketë siguruese(banderollat)						
13681	Bllombat						

1370	DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE (NENTOTALI)	279,900.00	279,320.31	99.79%	170,000.00	163,631.53	96.25%
13710	Vaj						
13720	Nafte per ngrohje qendrore	204,500.00	204,330.44	99.92%	120,000.00	118,623.35	98.85%
13730	Vaj per ngrohje						
13740	Mazut						
13750	Qymyr						
13760	Dru						
13770	Derivate per gjenerator	10,400.00	10,331.62	99.34%	10,000.00	9,999.50	100.00%
13780	Karburant per vetura	65,000.00	64,658.25	99.47%	40,000.00	35,008.68	87.52%

1380	LLOGARITE E AVANSIT (NENTOTALI)	-	-	-	-	-	-
13810	Avans per para te imeta (p.cash)						
13820	Avans per udhetime zyrtare						
13821	Avanc						
13830	Avans per mallra dhe sherbime						
13850	Avanc - per ambasadat						

1395	SHERBIMET E REGJISTRIMIT DHE SIGURIMEVE (NENTOTALI)	31,000.00	20694.41	66.76%	35,000.00	25,259.53	72.17%
13951	Regjistrimi dhe Sigurimi i automjeteve	21,000.00	20694.41	98.54%	25,000.00	17,759.53	71.04%
13953	Sigurimi i ndertesave dhe tjera	10,000.00		0.00%	10,000.00	7,500.00	75.00%

1400	MIRËMBAJTJA (NENTOTALI)	285,500.00	284,692.62	99.72%	285,000.00	253,181.52	88.84%
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	38,500.00	38,357.20	99.63%	40,000.00	20,678.96	51.70%
14020	Mirembajtja e ndertesave	171,000.00	170,939.50	99.96%	175,000.00	173,957.16	99.40%
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	40,000.00	39,867.50	99.67%	40,000.00	35,850.40	89.63%
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve	36,000.00	35,528.42	98.69%	30,000.00	22,695.00	75.65%

1420	SHPENZIMET E MARKETINGUT (NENTOTALI)	45,200.00	44,567.90	98.60%	40,000.00	29,292.80	73.23%
14210	Reklamat dhe konkurset	9,200.00	9,138.00	99.33%	10,000.00	6,883.00	68.83%
14220	Botimet e publikimeve	1,000.00	995.00	99.50%		-	
14230	Shpenzimet per informim publik	35,000.00	34,434.90	98.39%	30,000.00	22,409.80	74.70%
1430	SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT (NENTOTALI)	117,726.50	111,790.69	94.96%	128,103.00	45,812.25	35.76%
14310	Drekat zyrtare	117,726.50	111,790.69	94.96%	128,103.00	45,812.25	35.76%
14410	Vendime gjyqesore	31.50	31.50	100.00%	18,498.00	18,497.19	
14420					10,631.00	10,630.79	
					7,867.00	7,866.40	
Totali i shpenzimeve mallra dhe shërbime dhe komunal		1,828,612.00	1,746,727.35		1,506,051.25	1,110,485.73	73.73%

Shpjegim:

Siç shihet nga tabela e mësipërme në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve në vitin aktual kemi shpenzime më të vogla në të gjitha kategoritë ekonomike, kjo me faktin se në shtatë muajt e fundit të vitit Kuvendi pjesa politike nuk ka pasur aktivitete dhe si rrjedhojë e kësaj ka ndikuar në shpenzime më të pakëta në të gjitha kategoritë. Megjithatë kursimet e evidentuara deri më tani nuk mund të reflektojnë në diçka të keqe, sepse këto kursime në fund të vitit kanë shkuar si suficit në buxhejt e shtetit. Duhet theksuar se përveç faktit që ka kursime nga moskonstituimi i Kuvendit, ka edhe vonesa të procedurave të prokurimit në disa pika mjaft të rëndësishme e disa nga to janë: Përzgjedhja e auditorëve të jashtëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të partive politike, furnizimi me ujë të pijshëm, etj.. Duhet cekur se raporti i krahasimit në mes të buxhetit të planifikuar dhe atij të shpenzuar është bërë duke e krahasuar atë me buxhetin përfundimtar, respektivisht pas shkurtimeve të bëra në buxhet me vendim të Qeverisë, dhe të njëjtat janë përshtatur nëpër kategori ekonomike.

4.d) INVESTIMET KAPITALE: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS PROJEKTEVE

30000	INVESTIMET KAPITALE Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2013				Buxheti 2014		
		Planifikimi 2013	Buxheti perfundimtar SIMFK 2013	Shpenzimet 2013	% e shpenzimit	Buxheti 2014	Shpenzimet 2014	% e shpenzimit
	Gjithsej Investimet Kapitale	1,030,000.00	896,072.00	637,691.82	71.17%	943,421.00	420,335.65	44.55

Kodi i projektit	Shpenzimet kapitale	1,030,000.00	896,072.00	637,691.82	71.17%	943,421.00	420,335.65	44.55
8001	Villa Germia	10,000.00	-	-	0.00%	-	-	-
12907	Shkallet kunder zjarrit	5,904.00	9,904.00	4,840.00	48.87%	20,000.00	18,782.00	93.91
10198	Blerja e veturave për nevoja të Kuvendit të Kosovës	130,000.00	-	-	-	30,000.00	29,749.20	-
12609	Rifreskimi dhe pavarësimi i sistemit të TIK-ut	200,000.00	105,000.00	103,200.00	98.29%	66,000.00	66,000.00	100.00
12559	Renovimii aneksit (kulmi dhe fasada)	238,189.00	240,511.00	240,510.83	100.00%	-	-	-
12979	Modernizimi dhe pajisja me teknologji digjitale të sallave konferenciale dhe salles	250,000.00	290,000.00	144,870.00	49.96%	327,421.00	305,804.45	93.40
13431	Renovimi i ndërtesës dhe instalimeve ekzistuese	185,907.00	185,907.00	79,566.00	42.80%	450,000.00	-	-
13432	Dyer automatike në garazhe	10,000.00	9,750.00	9,750.00	100.00%	-	-	-
13795	Blerja e kamerave Vezhguese	55,000.00	55,000.00	54,954.99	99.92%	-	-	-
13877	Digjitalizimi i arkives	-	-	-	-	50,000.00	-	-

Shpjegim:

Në këtë kategori ekonomike kemi një ngecje të disa projekteve dhe atë si vijon: Renovimi i ndërtesës dhe instalimeve ekzistuese i cili si aktivitet ka filluar qysh në muajin mars, ndërsa projekti për digjitalizimin e arkivës ka filluar si aktivitet me vonesë dhe deri më tani nuk kanë përfunduar procedurat e prokurimit. Pra marrë në përgjithësi të projektet kapitale kemi vonesa të theksuara në procedurat e prokurimit.

4.e) SUBVENCIONET DHE TRANSFERET: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMI

TRANSPERET: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMI							
21000	Subvencione dhe Transfere Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2013			Buxheti 2014		
		Planifikimi	Shpenzimet vjetore	% e shpenzimit	Planifikimi	Shpenzimet vjetore	% e shpenzimit
Gjithsej subvencione dhe transfere		60,000.00	59,900.00	99.83%	30,000.00	6,800.00	22.67%
2100	SUBVENCIONET	60,000.00	59,900.00	99.83%	30,000.00	6,800.00	22.67%
21110	Subvencionet per Etnitete Publike	60,000.00	59,900.00	99.83%	30,000.00	6,800.00	22.67%
21120	Subvencionet per Etnitete Publike						
21200	Subvencionet per Etnitete Jopublike						
2200	TRANSFERET	-	-	-	-	-	

4.f) Personeli dhe struktura e pagave

Niveli	Pozitat e aprovuara me Ligjin për Buxhet	Pozitat e plotësuara	Buxheti përfundimtar për paga dhe mëditje	Buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje për periudhën raportuese	% e realizimit
1	2	3	4	5	6
Deputetët e Kuvendit	120	118+48	3,429,618.00	3,047,889.73	88.87%
Administrata e Kuvendit	185	170	1,761,796.00	1,668,084.05	94.68%
Stafi Mbështetës Politik	33	18	343,309.00	216,423.19	63.04%
Gjithsej	338	306+48	5,534,723.00	4,524,862.06	81.75%

Vërejtje:

Te numri i të punësuarve në muajin dhjetor kemi këtë gjendje:

Te deputetët kemi 110 deputet të Legjislaturës së pestë si dhe 48 deputet të cilët realizojnë pagën kalimtare dhe një pjesë deputetëve (tetë) të cilët janë zgjedhur me poste në Qeveri e të cilët marrin pagë deri më datë 8 dhjetor 2014.

Te programi i Administratës së Kuvendit është marrë nr. i të punësuarve në muajin dhjetor 2014.

Te programi i Stafi Mbështetës Politik është marrë nr. i të punësuarve në muajin dhjetor 2014.